



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivered	26.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupja e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
Sikmshet	5362/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.901/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.901/2023 të datës 30.06.2022, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër protokollit 910/2023 të datës 02.06.2023 të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.901/2023 e datës 30.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që brenda fatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi, të bëjë korigjimin e Vendimit me numër protokollit 910/2023 të datës 02.06.2023, ashtu siç përcaktohet në arsyetimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (*tutje ankuesi*), i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 30.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 910/2023 të datës 02.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes/ristrukturim të institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa kjo e fundit me datë 07.07.2022, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijes e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4985/2023 të datës 30.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 910 të datës 02.06.2023 të Departamentit për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i lëshuar nga Drejtori i DMZP-së; Aktgjykimin A.nr.1142/2022 të datës 14.03.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; E-maili i datës 09.06.2023 nga ankuesi për Ministrinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; E-maili i datës 02.06.2023 nga zyrtarja e personelit për ankuesin; Vendimi me A.nr.547/2022 të datës 01.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër protokoll 2987/2023 të datës 12.06.2023 të lëshuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Vendimin me numër nr.811/2023 të datës 09.06.2023 i lëshuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Akt emërimit e ankuesit të datës 23.10.201; Vendimin me nr.1284/2014 të datës 18.06.2014 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Kërkesa për Përgjigje në ankesë e datës 03.07.2023 për organin e punësimit nga Këshilli; Përgjigjen në ankesë me nr.protokoll 901 e datës 07.07.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Organogrami i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Vendimin me nr.197/2022 i datës 13.12.2022 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të Drejtorit të Përgjithshëm për Financa Shërbime të Përgjithshme të lëshuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Vendimin me numër protokoll 6245/2022 të datës 13.12.2022 të lëshuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Vendimin me numër protokoll 2972/2023 të datës 09.06.2023 të lëshuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, emaili i datës 25.07.2023 i KMSHCK-së drejtuar organit të punësimit, provat shtesë me numër protokoll A.910/2023 si: emali i datës 25.07.2023 nga Zyrtarja në pozitën e Zyrtares së Personelit në MKRS dhe emali datës 25.07.2023 nga Zyrtari në pozitën e Zyrtarit të Personelit në MKRS.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe së i njëjti sipas Akt të emërimit me numër protokoll 2540/2012 të datës 31.10.2012, është i emëruar në pozitën *Menaxher i IT-së* në Departamentin e Administratës Qendrore.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në zbatim të Vendimit më numër protokoll 910 të datës 02.06.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me Vendimin nr.811/2023 të datës 09.06.2023 ka shfuqizuar Vendimin Nr.1638/2022 të datës 14.12.2022, me të cilin ankuesi nga pozitat e Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji të Informacionit dhe Shërbime Logjistike, ishte caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Rrejdhimisht me Vendimin me numër protokoll 910 të datës 02.06.2023, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka bërë transferimin e nëpunës civile Malique për shkak të ristrukturimit të institucionit, ku e njëjta nga pozita e Drejtorit të Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është sistemuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerr me zbatim të gabuar të ligjit material. Kërkon që Këshilli të anuloi aktin administrativ të kundërshtuar me ankesë në mënyrë që të kthehet ligjshmëria sipas nenit 18 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në KPSHCK.

Në vështrim të dispozitave ligjore të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe në kuptim të konstatimit të pranushmerisë së ankesës A.nr.901/2023 Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative se kush konsiderohet palë në

procedurë përketesisht nenit 14 të këtij ligji sipas të cilit *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative*", si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, rrjedhimisht referuar këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson se me Vendimin e kundërshtuar më ankesë nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, sepse ankuesi sipas Akti të Emërimit të Përherëshëm mbanë pozitën e punës Menaxher i IT-së në Departamentin e Administratës Qendrore, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe se i njëjti në pozitën e Drejtorit të Financave dhe Shërbime të Përgjithshëm ka qenë i caktuar vetëm si zëvendësues, pra ankuesi ishte caktuar vetëm përkohësisht në këtë pozitë dhe e cila pozitë bazuar në konstatimin si në vendimin e kundërshtuar ka qenë pozitë e lirë, andaj, mbi këtë arsye rrjedhë së ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.901/203 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit bazuar në analizimin e shkresave të lëndës ka gjetur se sipas Vendimit më numër protokollit 910 të datës 02.06.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, emërtimi i pozitës në të cilën është bërë transferimi i nëpunës civil evidentohet Drejtor i Departamentit për Shërbimet e Menaxhimit të Përgjithshëm, ndërsa sipas Vendimit nr.811/2023 të datës 09.06.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i nxjerr në zbatim të Vendimit numër protokollit 910 të datës 02.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, evidentohet Drejtori i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Në këtë kontekst dhe bazuar në konfirmimin nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit rezultoi se emërtimi i pozitës në fjalë është Drejtori i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, andaj, mbi këtë bazë Kolegji vendosi si në pikën dy të dispozitivit, me obligimin që Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të bëjë korrigjimin e Vendimit me numër protokollit 910 të datës 02.06.2023 lidhur me emërtimin pozitës në të cilin është bërë transferimi i nëpunës civil për shkak të ristrukturimit, ashtu që emërtimi i pozitës të jetë në pajtueshmëri me emërtimin siç përcaktohet me Rregulloren në fuqi Nr. 01/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përmbledhur si me lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.901/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

